V E N D I M
Nr.364, datë 21.7.1993

PËR PËRDORIMIN E FITIMIT TË NDËRMARRJEVE JOBUXHETORE PËR FINANCIM NË FUSHËN E NDËRTIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 11 të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndërmarrjet shtetërore, nacinale dhe lokale, kanë të drejtë të financojnë veprimtari të përbashkëta në fushën e ndërtimeve publike, që ndërmerren nga organet e pushtetit lokal të juridiksionit ku kanë qendrën ndërmarrjet. Financimi mund të kryhet vetëm për objekte të natyrës ndërtimore dhe kur për këto objekte ka projekte dhe preventiva të miratuara rregullisht.

2. Ndërmarrjet shtetërore përdorin si burim financimi "Rezervat e tjera", të cilat krijohen nga fitimi neto në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore".

3. Për pjesëmarrjen në financimin e veprimeve të përbashkëta të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të drejtën e marrjes së vendimit e ka këshilli drejtues i ndërmarrjes shtetërore. Për ndërmarrjet nacionale duhet të merret edhe miratimi i titullarit të ministrisë apo i institucionit tjetër qëndror.

4. Për kontributin në financimin e veprimtarive të përbashkëta të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, ndërmjet organit të pushtetit lokal dhe ndërmarrjeve lidhet aktmarrëveshje.

Në aktmarrëveshje specifikohet projekti përkatës, kontributi i ndërmarrjes, afatet e derdhjes së tij dhe kushtet e tjera të nevojshme.

5. Derdhja e kontributit të ndërmarrjes do të bëhet në llogarinë e të ardhurave të buxhetit të çelur në emër të Degës së Thesarit të rrethit përkatës, e cila kryen financimin vetëm në bazë të situacioneve faktike për punimet e kryera për secilin projekt. Për raste të veçanta dhe me autorizim të titullarit të organit të pushtetit lokal që ndjek zbatimin e projektit ose të punonjësit të ngarkuar prej tij, ndërmarrjes që kryen punimet i jepet avancë deri në 20 për qind të vlerës gjithsej të projektit.

6. Financim i drejtpërdrejtë nga ndërmarrja kontribuese nuk mund të bëhet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi